



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura III**

---

Komisioni për Punë të Jashtme  
Mbledhja nr. 23  
Prishtinë, më 05.06.2009, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**P r o c e s v e r b a l**

**Nga takimi i Komisionit për Punë të Jashtme me Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në NATO, z. Artur Kuko**

Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në NATO, z. Artur Kuko në takim e shoqëroi ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës z. Islam Lauka.

Në takim nga anëtarët e Komisionit morën pjesë: z. Sabri Hamiti kryetar i Komisionit, z. Xhavit Haliti, z. Ramadan Avdiu, z. Nexhat Daci dhe z. Ardian Gjini.

Munguan: z. Enis Kervan, z. Ramë Buja, z. Eqrem Kryeziu, z. Lutfi Haziri, z. Ibrahim Gashi dhe z. Dragisha Miriq.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Ilaz Rudaku.

*Mbledhjen e kryesoi Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.*

**R E N D I I D I T Ë S**

**1. Takimi i Komisionit me Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në NATO, z. Artur Kuko.**

**Sabri Hamiti** fillimisht tha se ndihemi të nderuar për prezencën e Ambasadorit të Shqipërisë në NATO z. Artur Kuko në mesin e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Prezantoi anëtarët e pranishëm të Komisionit dhe njoftoi se Komisioni për Punë të Jashtme është themeluar për herë të parë në këtë legjislaturë. Sa i përket punës së Komisionit tha se, Komisioni tani gjendet në fazën e procesit të dëgjimit të kandidatëve për ambasador në bashkëpunim me Ministrin e Punëve të Jashtme, ndërsa në përgjithësi Kuvendi është në proces të shumëfishtë të punës, rreth nxjerrjes së legjislacioni, krijimit të kontakteve me jashtë si dhe procesit të lobimit për njohje. Falënderoi Shqipërinë për gjithë përkrahjen që i dha Kosovës, të vetëdijshëm se kjo përkrahje nuk do të mungojë edhe në të ardhmen.

**Artur Kuko** falënderoi anëtarët e Komisionit për pritjen dhe shtoi se është i privilegjuar që ka pasur mundësi t'i ndjek zhvillimet në Kosovë, qoftë në dimensionin e BE-së dhe tani në misionin e NATO-s. Në vazhdim tha se si vend anëtar i NATO-së, besoj që duke shprehur interesat e Shqipërisë brenda aleancës jam në gjendje t'i shpreh edhe interesat e Kosovës. Dy shtyllat kryesore që NATO aplikon ndaj Kosovës janë prania e forcave të saja dhe tjetra është detyra për ngritjen e Forcës së

Sigurisë së Kosovës. Sa i përket ngritjes së FSK-ës tha se Shqipëria do të mbështes politikën e aleancës për të ndihmuar me aq mundësi sa ka, vitin e kaluar ka kontribuar me 250 mijë euro në një fond mirëbesimi të aleancës që i kushtohet ngritjes së FSK-së. Fondi për ngritjen e FSK-së tha se është akoma deficitar për rreth 17 milion euro, ku përveç kontributit tonë modest që do t'a japin tha se po përpiqemi që të llojmë edhe në vendet e tjera në mënyrë që të arrihet plotësimi i shumës së nevojshme për ngritjen e FSK-së. Gjithashtu tha se në kërkesë të aleancës planifikojmë të dërgojmë 3 ekspert nga më të mirët, që do të punojnë në Ministri.

**Nexhat Daci** tha se gjatë këtyre dhjetë viteve të prezencës së NATO-së në Kosovë, asnjë ushtar i NATO-së nuk është dëmtuar, që është meritë e klasës politike dhe e qytetarëve të Kosovës, që t'i respektojnë ata, që i ofruan ndihmë në momentin e duhur. Një epërsi e madhe strategjike për rrugëtimin e Kosovës në NATO, është aderimi i Shqipërisë si anëtare e rregullt e NATO-së dhe mundësia që ambasadori i Shqipërisë të ketë një përkrahje të fuqishme dhe të plotë nga institucionet e Kosovës, për ta përfaqësuar edhe Kosovën në institucionin që e përfaqëson Shqipërinë.

**Ramadan Avdiu** uroi ambasadorët për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Vlerësimi pozitiv për FSK-në tha se na inkurajon që të punojmë edhe më shumë ndërsa ekspertët nga Shqipëria janë të mirëseardhur.

**Ardian Gjini** i shprehu mirënjohje dhe e falënderoi ambasadorin Artur Kuko për vizitën, ndërsa për pranimin e Shqipërisë në NATO, tha se ka qenë një ndjenjë e jashtëzakonshme për të gjithë.

**Sabri Hamiti** tha se hyrjen e Shqipërisë në NATO, e kemi përjetuar si sukses të jashtëzakonshëm shqiptarë, dhe jemi të bindur se kjo është siguri e shqiptarëve në kuptimin strategjik e politik. Besoj se do të ketë bashkëpunim të madh, në mes jush dhe ambasadorit të ardhshëm të Kosovës në Bruksel si dhe intensifikim të kontakteve me Prishtinën dhe Tiranën.

**Artur Kuko** mendon se duhet të punohet për forcimin e institucioneve, sepse me institucione të forta suksesi do të jetë më i lehtë tek partnerët dhe miqtë .

Takimi përfundoi në orën 11.25 min.

Kryetar i Komisionit  
Sabri Hamiti

E përgatiti:  
Njësia për Mbështetje të Komisionit